



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNAVË

02-10-2023

Pranor - Prirënie MEOGana

Nr./ organik	Numri/ broj	Prirënie	MEO
Org. broj			

01-110/05-1197



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, neni 40, paragrafi 40.2, pika b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 të Kuvendit të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare Nr.28/2008), neni 2 dhe 4 i Ligjit për financat e pushtetit lokal Nr. 03/L-049, neni 35, paragrafi 35.2, pika b të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më datën 27.09.2023 merr këtë:

V E N D I M

për transferin (rialokimin) e mjeteve buxhetore në mes programeve, nëprogrameve buxhetore në kategorinë ekonomike të investimeve kapitale

Neni 1

Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për transferin (rialokimin), rregullimin e ndarjeve buxhetore të organizatës buxhetore, granti qeveritar, fondi burimor 10 dhe të hyrat vetanake fondi burimor 21, kategoria ekonomike investime kapitale në mes programeve, nëprogrameve buxhetore, si vijon:

Fondi burimor 10:

- Kategoria ekonomike investime kapitale të ridestinoen mjetet mes projekteve (shuma 59,666.04 €);
- Programi buxhet e financa (175), nënprogrami buxhetimi (17533).

Nga projekti: Rregullimi i çerdhës në Drobesh (adaptimi i shkollës fillore të vjetër në çerdhe), kodi i projektit 52662, shuma prej 59,666.04 €,

Në projektin: Asfaltimi i rrugëve Viti, Beguncë, Lubishtë, Kabash, Buzovik, Drobesh, Ramnishtë, Smirë, Podgorc, Gërmovë, kodi i projektit 53815, shuma prej 59,666.04 €.

Fondi burimor 21:

- Kategoria ekonomike investime kapitale të ridestinoen mjetet mes projekteve (shuma 70,000.00 €);
- Programi buxhet e financa (175), nënprogrami buxhetimi (17533).

Nga projektet: Punimet në ujësjellësin për rritjen e kapaciteteve të ujit në Letnicë, kodi i projektit 51457, shuma prej 40,000.00 € ; Rregullimi i çerdhës në Drobesh (adaptimi i shkollës fillore të vjetër në çerdhe) kodi i projektit 52662, shuma prej 30,000.00€.

Në projektet: Ndërtimi i fushave sportive në Stubëll të Epërme, Budrikë, Sodovinë e Çerkezëve, Remnik, Radivojc, Goshicë, Debëlldeh, kodi i projektit 53856, shuma prej 60,000.00 €; Asfaltimi i rrugëve Viti, Beguncë, Lubishtë, Kabash, Buzovik, Drobesh, Ramnishtë, Smirë, Podgorc, Gërmovë, kodi i projektit 53815, shuma prej 10,000.00 €.

Neni 2

Pas lejimit të ridestinitimit të mjeteve nga neni 1 i këtij vendimi nga Ministria për Financa, Punë dhe Transfere, Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim do të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi.

Neni 3

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 8, lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për procedurat e hartimi dhe publikimi të akteve të komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyra së Kryetarit;
2. Drejtorisë për Financa;
3. Shërbimit të Kuvendit;
4. MAPL-së; dhe
5. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
KRYESUESI

Bekim Azizi

